

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Udhëtimi i jashtëzakonshëm i britanikut/ Ecje në këmbë rreth botës për 28 vite rresht
ADRESA	https://www.cna.al/kuriozitet/udhetimi-i-jashtezakonshem-i-britanikut-ecje-ne-kembe-rreth-botes-pe-i475279
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:33:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 17:18:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fd4d6518ac9a8987229a7bf0aa20dcd2a2003993dc6e2d98b7f151451d12b5d8
TEKSTI	97ebf72f6880ba6c34c1fd9595ad1eafa76ed84270efb7d310040d29bebb68c5
PAMJA	8e51979e210f7e6799ef7dafb0783e4524e653289e2a3bafb92c92c84a62f5f2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e801447025d6f540de7a9b1d9f3db4bb26146f4d5ae717fe16cef73a41d019ca
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e801447025d6f540de7a9b1d9f3db4bb26146f4d5ae717fe16cef73a41d019ca>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Udhëtimi i jashtëzakonshëm i britanikut/ Ecje në këmbë rreth botës për 28 vite rresht



26 Shtator 2026, 19:18, Kuriozitete CNA



Si një parashutist i ri dhe energjik në mesin e viteve 1990, Karl Bushby dëshironte aventura në një periudhë relativisht paqësore.

Duke u ndier gjithnjë e më i pakënaqur dhe i lënduar nga fundi i një martese të hershme, atij i lindi një ide e pazakontë: të ecte rreth botës, duke ndjekur një itinerar prej 50 mijë kilometrash nga skaji jugor i Kilit deri në shtëpinë e nënës së tij në Hull, në veri të Anglisë.

Kur u nis nga Punta Arenas në nëntor të vitit 1998, ishte 29 vjeç.

Pothuajse tri dekada më vonë, ai është vetëm pak ditë larg bregut francez. Nëse gjithçka shkon sipas planit, Bushby do të përpiqet të kalojë me not Kanalin e La Manshit dhe më pas do të bëjë kilometrat e fundit në këmbë drejt shtëpisë.

Ideja lindi kur Bushby ishte ende parashutist në ushtrinë britanike.

Në një periudhë relativisht të qetë martese, atij i naqë kështu në fund dhe ai lëvizte ditë e ditë lartë në shtyllë të botës.

Ishte një periudhë relativisht e qetë, mbase e tij e parë kaqë përmbante një ditë të rëndësishme që u jepte një qimim jetës.

Teksa përgatitej të largohej nga ushtria, kujton se qëndronte mbi shkëmbinjtë e bardhë të Kentit, pranë Doverit, duke imagjinuar ditën kur do të shfaqej përsëri aty, i lodhur dhe i rraskapitur, pasi të kishte përshkuar botën.

Që në fillim, vendosi dy rregulla të panegociueshme: të mos përdorte asnjë mjet transporti për të përparuar në itinerar dhe të mos kthehej në Britani derisa të mbërrinte atje me forcat e veta.

Udhëtimi që parashikohej të zgjaste 12 vjet u kthye në një aventurë prej gati tri dekadash.

Në rrugë, Bushby ka kaluar Dariën Gap, zonën famëkeqe mes Kolumbisë dhe Panamasë, ku u përball me guerrilë, trafikantë droge dhe gjarpërinj helmues.

Ka përshkuar shkretëtira, male dhe akull, ndërsa ka notuar rreth 300 kilometra përmes Detit Kaspik.

Në vitin 2006, ai kaloi mbi akullin e lëvizshëm të Ngushticës së Beringut nga Alaska drejt Rusisë. Por sapo mbërriti në anën tjetër, u arrestua pasi nuk kishte hyrë përmes një pike zyrtare kufitare.

Në lirin e tij ndërhyri John Prescott, atëherë zëvendëskryeministër britanik, i cili kontaktoi guvernatorin rajonal të kohës, Roman Abramovich.

Megjithatë, pikërisht pengesa që dukej më e vogla në hartë është bërë një nga më të vështirat. Bushby kishte shpresuar të ecte përmes një tuneli shërbimi të Eurotunelit, por kërkesa iu refuzua.

Më pas nuk mori leje as për të notuar nga Franca drejt Anglisë, pasi autoritetet franceze nuk lejojnë nisjen e notarëve të Kanalit nga brigjet e tyre. Ai ende synon të arrijë në Hull në fillim të nëntorit. Vonesat kanë qenë të shumta.

Problemet me vizat e kanë detyruar të ndërpresë udhëtimin për periudha të gjata, ndërsa pandemia e ndaloi sërish. Për disa kohë, Meksika u bë baza e tij e përkohshme, një vend relativisht i lirë ku mund të priste derisa të hapet rruga përpara.

Në një rast, kaloi një vit duke bërë një devijim nga Los Angeles drejt ambasadës ruse në Washington për të kundërshtuar refuzimin e vizës. Por pas kaq shumë vitesh, thotë ai, ideja e dorëzimit nuk ekziston më.

Ndërkohë që Bushby ishte i zhytur në udhëtimin e tij, bota e aventurës ekstreme ndryshoi.

Udhëtime që dikur konsideroheshin pothuajse të paimagjinueshme janë kthyer në objektiva për një komunitet gjithnjë e më të madh udhëtarësh.

NomadMania, një platformë që rendit udhëtarët sipas vendeve dhe rajoneve të vizituara, thotë se në vitin 2008 vetëm rreth gjashtë persona në vit arrinin të vizitonin të 193 shtetet e njohura nga OKB-ja.

Vitin e kaluar ishin 85, ndërsa sot njihen më shumë se 500 persona që e kanë plotësuar këtë listë.

Një prej tyre është danezi Torbjørn "Thor" Pedersen. Në vitin 2013, ai u nis të vizitonte çdo vend të botës në një udhëtim të vetëm dhe pa përdorur avion. Mendonte se do t'i duheshin katër vjet. Në fund iu deshën dhjetë.

Gjatë rrugës udhëtoi me 37 anije mallrash, i mbijetoi malaries cerebrale në Ganë dhe kaloi pandeminë në Hong Kong. Me kalimin e kohës, ajo që kishte nisur si një garë për të plotësuar listën e vendeve u kthye, sipas tij, në një udhëtim për njerëzit që takonte.

Vizitat ekstreme janë bërë më të lehta falë vizave elektronike, punës në distancë dhe rrjeteve sociale. Por ato mbeten të kushtueshme. Bushby dhe Pedersen janë mbështetur në donatorë, sponsorë pajisjesh dhe marrëveshje për libra dhe filma.

Edhe historia e Bushby ka tërhequr Hollivudin.


Producentët Jordan Tappis dhe Beau Willimon, të lidhur me produksione si *House of Cards* dhe *Severance*, e kanë mbështetur prej vitesh financiarisht dhe logjistikisht.

Qindra orë filmime nga udhëtimi i tij pritet të përdoren për një film të drejtuar nga Werner Herzog. Por ndërsa fundi afrohet, Bushby nuk flet vetëm për triumfin.

Ai nuk ka shkelur në Angli prej 28 vjetësh dhe e di se pas gjithë atyre viteve në lëvizje, kthimi në shtëpinë e nënës së tij do të jetë një ndalesë e menjëhershme.

Trupi gjithashtu po i kujton se udhëtimi duhet të marrë fund. Bushby tashmë çalon lehtë dhe ka humbur numërimin e çizmeve që ka konsumuar gjatë rrugës.

Në përfundim të tij mbetet Kanali i La Manshit, pengesa e fundit mes një burri që nisi të ecte në vitin 1998 dhe shtëpisë ku ka 28 vjet që përpiqet të mbërrijë./ Financial Times





Të sugjeruara

Argjentina vendos linjën e parë hekurudhore me energji diellore

Çfarë ndodh në trup kur na kap adrenalina? Ja si funksionon hormoni që na vë në alarm

Sa insekte fluturojnë mbi kokat tona?/ Zbulohet shifra marramendëse

A ndiejnë kafshët gëzim?

Pse matematika është më e vështirë për disa fëmijë?/ Skanimet e trurit zbulojnë një të dhënë të rëndësishme

Si arrijnë gjarpërinjtë të qëndrojnë në këmbë pa pasur këmbë?/ Shkencëtarët zbulojnë sekretin

Pse Piramida e Madhe nuk u shkatërrua nga tërmetet për 5 mijë vjet?/ Shkencëtarët zbulojnë sekretin

Shkencëtarët zbulojnë një specie të re maceje të egër për herë të parë në 100 vjet

4 mitet për kremrat kundër diellit që shumë njerëz ende i besojnë

Si i shmangin pilotët stuhitë gjatë fluturimit?/ Ja çfarë ndodh kur nuk kanë zgjidhje

Bora nuk është në të vërtetë e bardhë/ Ja pse sytë tanë e shohin kështu

Pse nuk flemë mirë në një vend të ri? Truri ynë qëndron “në gatishmëri”

Çfarë fshihet brenda një fije kaçurreli? Zbulimi që mund të ndryshojë mënyrën si kujdesemi për flokët

Pse na thinjen flokët? Shkencëtarët zbulojnë rolin e qelizave staminale

Po e pini kafënë në orën e gabuar? Ja kur duhet ta konsumoni për më shumë efekt

Pse çokollata e Dubait u bë kaq virale? Psikologjia shpjegon suksesin e saj

Studimi/ Qentë mund të përmirësojnë shëndetin mendor të adoleshentëve

Kujtime të rreme/ Pse truri ynë mund të na bindë për diçka që nuk ka ndodhur kurrë?

Pse kafeja ka shije të hidhur? Shkencëtarët zbulojnë çfarë ndodh në nivel molekular


7 mënyra të çuditshme se si tualetet kanë shkaktuar vdekje

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.